



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog
Tužioca / Office of the Chief State Prosecutor

A.nr.360/16
më 29 Qershor 2016
Prishtinë

Pas konsultimeve me prokurorët e Zyrës së kryeprokurorit të Shtetit, lidhur me praktikën e aplikimit të ndërmjetësimit, si procedurë alternative, në rastet e dhunës në familje, më 29 Qershor 2016, lëshoj këtë

U D H Ë Z I M

-Rastet e dhunës në familje, Prokurorët e Shtetit, në asnjë rast mos t'i dërgojnë në ndërmjetësim, si procedurë alternative për zgjidhjen e rasteve.

-Rastet e dhunës në familje përfshijnë, si veprën penale, Shkelja e urdhërit mbrojtës, nga neni 25 të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, poashtu edhe veprat tjera penale, të cilat kryhen apo tentohen të kryhen kundër personit me të cilin kryesi ka qenë apo është në marrëdhënie familjare, përkatësisht rastet kur kemi të bëjmë me viktime të ndjeshme e ku është përfshirë si i dëmtuar partneri familjar (Neni 120, pika 37 i KPRK).

A r s y e t i m i

Zyra e kryeprokurorit të Shtetit, ka vërejtur se prokurorët që merren me rastet e dhunës në familje, qoftë kur trajtojnë rastet e shkeljeve të urdhërave mbrojtës, qoftë kur i trajtojnë rastet tjera me elemente të dhunës në mes partnerëve familjarë, shpesh herë kallëzimet penale i dërgojnë në ndërmjetësim, tek ndërmjetësi i çertifikuar.

Praktika e referimit të kallëzimeve penale tek ndërmjetësit, për rastet e dhunës në familje nuk është në pajtim as me ligjin vendor (KPPRK), e as me instrumentet ndërkombëtare që mbulojnë këtë fushë.

KPPRK, në nenin 232 par.1, tek procedurat alternative, kur flet për ndërmjetësimin thotë:

“Prokurori i shtetit mund ta dërgojë kallëzimin penal për një veprë penale të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet për ndërmjetësim. Para se të veprojë kështu, prokurori i shtetit merr parasysh llojin dhe natyrën e veprës, rrethanat në të cilat ajo është kryer, personalitetin e kryerësit dhe dënimet e mëparshme të tij për të njëjtën veprë penale apo për vepra penale të ndryshme, si dhe nivelin e përgjegjësisë penale të tij”.

Kjo don të thotë se jo çdo herë një rast mund të referohet për ndërmjetësim kur plotësohen kushtet formale ligjore, por duhet shikuar edhe rrethanat tjera, përfshirë si më të rëndësishmet, llojin dhe natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer, personalitetin e kryesit, ..etj.

Veçanërisht tek rastet e dhunës në familje, natyra e veprës penale është e tillë që nuk lejon shprehje të lirë të vullnetit, nga ana e të dëmtuarit, çka viktimën dhe kryesin i bën palë të pabarabarta në procedurë.

Për më tepër, Ligji për ndërmjetësim, neni 10 par. 1, thotë:

“ palët në procedurë janë të lira të vendosin për zhvillimin e procedurës së ndërmjetësimi”

ndërsa më tutje :

“ndërmjetësimi fillon pas nënshkrimit të marrëveshjes së palëve për fillimin e procedurës së ndërmjetësimi-par. 3 i nenit 10”.

Poashtu, neni 12 par 1 i Ligjit mbi ndërmjetësimin, taksativisht thotë:

“Arritja e marrëveshjes në procedurën e ndërmjetësimi, varet ekskluzivisht nga vullneti i palëve”.

Nga gjithë këto rrjedh përfundimi se dy palë, njëra që ka ushtruar dhunë dhe pushtet dominimi, ndërsa tjetra viktimë e dhunës dhe e nënshtruar këtij dominimi, nuk mund të lidhin marrëveshje bazuar në vullnetin e dyanshëm.

Përveç ligjit vendor, që tërthorazi e ndalon ndërmjetësimin në rastet e dhunës në familje, edhe Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin

dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, e quajtur edhe si Konventa e Stambollit, e miratuar në Stamboll, më 11 maj 2011, në nenin 48 – Ndalimi i proceseve të detyrueshme alternative të zgjidhjes së konflikteve ose dënimit, në nenin 1, thekson:

“Palët marrin masat e nevojshme legislative, ose masa të tjera për të ndaluar proceset e detyrueshme alternative të zgjidhjes së konflikteve, duke përfshirë ndërmjetësimin dhe pajtimin, në lidhje me të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj konvente”.

Se duhet bërë ndryshime në trajtimin e rasteve të Dhunës në familje, flet edhe një studim i bërë lidhur me vlerësimin e programit të Kosovës kundër dhunës në familje dhe planit të veprimit, 2011-2014, i cili ka nxjerr ndjekjen penale si hallkën më të dobët në gjithë zbatimin e kësaj strategjie.

Në vlerësimin e bërë kësaj fushe, në mes tjerash është rekomanduar se duke qenë se dhuna në familje është model ciklik i sjelljes, siguria e viktimës dhe bashkimi i familjes janë qëllime të papërputhshme kur marrëdhënia përfshin dhunë në familje.

Nisur nga këto arsye, konsideroj se zbatimi i këtij udhëzimi do të bëjë që çështja e dhunës në familje të adresohet me më shumë seriozitet dhe përgjegjësi, ndërsa viktimave do t’u mundësohet trajtim i duhur dhe i barabart në të gjitha rastet dhe në tërë teritorin e vendit.

Kryeprokurori i Shtetit

Aleksandër Lumezi

A. Lumezi
Udhëzimi ti dërgohet

- Të gjithë Kryeprokurorëve të Prokurorive Themelore të cilët nga një kopje të këtij udhëzimi të ia dorëzojnë prokurorëve të shtetit nëpër ato prokurori,
- U.D të Kryeprokurorit të Kryeprokurorit të PSRK-së i cili nga një kopje të këtij udhëzimi të ia dorëzoj prokurorëve special në atë prokurori,
- U.D të Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit I cili nga një kopje të këtij udhëzimi të ia dorëzoj prokurorëve të shtetit të zyrës së tij,
- Arkivit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit,

Obligohet sekretariati i KPK-së, që këtë udhëzim ta publikoj në Web faqen e Prokurorit të Shtetit.